



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME VLORË SH.A

Nr Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Menyra e perfundimit të kërkesës	Tarifa
1	05.09.2025	Projektin e Ujësjetllësi Tragjas-Himarë	15.09.2025	<p>Projekti i furnizimit me ujë të zonave bregdetare zonat e investimit strategjik Draleos-Drimadhës-Dhërmi është një investim që bëhet nga Buxheti i shtetit nëpërmjet AKUK.Vlera e këtij investimi është 943,004,448.7 lekë Ky investim nisi në Muajn Shkurt 2025. Parashikohet të përfundojë në vitin 2026. Kompania e cila po zbaton projektin është Gjoka Konstruksion. Përfituesit e realizimit të këtij investimi do të jenë fshatrat Palasë, Gjilekë, Kondraq dhe Dhërmi si dhe gjithë zonën turistike bregdetare. Gjurma e këtij projekti është sipas planimetrisë bashkëngjitur materialit. Burimi i cili do të merret uji janë burimet e Izvorit, Tragjas. Leja e përdorimit të burimit ujqor nëntokësor me nr. 2/11Prot., datë 21.07.2024 është miratuar nga Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë për burimin me koordinatat X: 458427.65; Y: 4465448.51; Z:16 m.m.n.d. Në lejen e lëshuar është përcaktuar gjithashtu se prurja ekologjike është 186 litra/sekondë, që nënkupton se kjo prurje do të jetë gjithmone në rrjedhje të lirë lumore për ti shërbyer ekosistemit duke mos shkaktuar shqetësime në mjedis. Zona Palasë - Dhërmi është zonë e varfër me burime ujore. Aktualisht janë dy sisteme ujësjetllësi ku në total përfitohen maksimalisht 30 l/s prurje e cila në periudhën e thatë të verës reduktohet deri në 5 l/s. Kjo sasi është e pamjaftueshme për të furnizuar zonën me zhvillim shumë të avancuar turistik. Ky ujësjetllës me perspektive zhvillimi 25 vjecare është parashikuar të furnizojë rreth 50,000 banorë sipas Planit të Zhvillimit Vendor të zonës. Për këtë projekt është përgatitur Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis VNM dhe është aplikuar për aprovim tek Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). AKM me Vendimin për VNM Paraprake datë 15.02.2023 ka vendosur që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM të thelluar. Në këtë kuadër bazuar në kërkesat e Vendimit Nr. 686 datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", Kreu I "Zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis", Shtojca I "Kriteret ndihmëse për marrjen e vendimit gjatë procedurës paraprake të VNM-së", nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e treta të interesuara. Konsultimet duhet të kryhen vetëm në rastin e hartimit të raportit të thelluar të VNM, gjë e cila nuk është kërkuar nga AKM për këtë projekt. Siç kemi sqaruar me lart zona Palasë - Dhërmi është shumë e varfër me burime ujore dhe kjo është arsyeja që është zgjedhur burimi Izvor i ndodhur në fshatin Tragjas i cili ka prurje të mëdha që mjaftojnë jo vetëm për furnizimin me ujë të fshatit Tragjas dhe zonën bregdetare të Radhimës por edhe për përdorim për bujqësi nga banoret e Tragjasit. Aktualisht këto burime kanë sasi shumë të mëdha uji që nuk përdoren dhe derdhen në det. Prej 5 vjetësh është në operim Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura për zonën e Palasës duke përfshirë dhe zonen turistike "Green Coeast". Në vitin 2024 u vendos në funksion rrjeti i kanalizimeve dhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura për zonën e Drimadhës. Është përgatitur projekti teknik për rrjetin e kanalizimeve dhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura për zonën Dhërmi, i cili pritet të financohet. Bashkëlidhur planimetria e gjurmës së projektit. Halim Hamzallari</p>	E plotë	Ska

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE VITI 2026

Nr Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Menyra e perfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	05.01.2026	1.Mungesa e klorizimit dhe e dokumentacioneve bashkëshoqëruese; 2. Mungesa e ujit në pikën e furnizimit të zonës së Rradhimës dhe Tragjasit.	23.01.2026	<p>Në vijim të ankesës së paraqitur nga Qendra Konsumatori Shqiptar, mbi mungesen e klorinimit dhe mungesën e ujit në pikën e furnizimit të zonës së Rradhimës dhe Tragjasit, Shoqëria jonë në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit të Shëndetit Publik, Vlorë dhe Institutit të Shëndetit Publik, Tirane, më dt. 06.01.2026 bëri inspektim në terren për të analizuar me detaje këtë problematikë të paraqitur. Inspektimi rezultoi në marrje kampionesh në terren, konkretisht në Stacion pompimi Tragjas, depo Tragjas, depo Rrahime, pika fundore të ndryshme të zonës. Shoqëria jonë do të kthejë një përgjigje të detajuar ditet në vazhdim pasi të marrim rezultatet nga ISHP.</p> <p>Koordinator per te drejten e informimit ne AKUK Koordinator per te drejten e informimit te SHRUK Vlore Grisela Lamaj Perditesuar ne 23-01-2026</p>	E plotë	S'ka